

**PASQYRAT FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR ME  
31 DHJETOR 2012**

Se bashku me Raportin e Audituesit

Per : **SHQIP Sh.p.k.**

**PËRMBAJTJA**

	<b>FAQE</b>
<b>RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR</b>	<b>1</b>
<b>PASQYRAT FINANCIARE:</b>	
<b>BILANCI KONTABËL</b>	<b>2</b>
<b>BILANCI KONTABËL (VAZHDIM)</b>	<b>3</b>
<b>PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE</b>	<b>4</b>
<b>PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË</b>	<b>5</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL</b>	<b>6</b>
<b>SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE</b>	<b>7 – 17</b>



AUDIT & ACCOUNTING

Adresa Rr. Ismail Qemali  
Pall. 34/1 Ap. 2/1  
Tirane, Albania

Phone: (+355 4) 2278 028  
Fax: (+355 4) 2278 028  
Email : luan.kamberi@ild-99.com

## RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare te Shoqerise "SHQIP" sh.p.k.

Drejtuar:

ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE

Lidhur me shqyrtimin e llogarive vjetore te periudhes Janar – Dhjetor 2012

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te shoqerise SHQIP Sh.p.k. (me poshte "Shoqeria") qe permbajne bilancin kontabël me date 31 Dhjetor 2012 si dhe pasqyrën perkatese te të ardhurave dhe shpenzimeve për ketë ushtrim, pasqyrën e fluksit te parase dhe pasqyrën e ndryshimeve te kapitaleve te veta, dhe të tjera shënime sqaruese.

### Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajne keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabile; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabile të arsyeshme për rrethanat financiare.

### Përgjegjësitë e Audituesit të Pavarur

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion për pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin e kryer. Ne kryem auditimin tone në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikes dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë një siguri të mjaftueshme që pasqyrat financiare nuk përmbajne keq-deklarime materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumatat dhe deklarimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshire vlerësimin e rrezikut të keq-deklarimeve materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të shoqerisë në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqerisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe pranueshmërinë e çmuarjeve kontabile të kryera nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë.

### Opinion

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare te Shoqerise "SHQIP" shpk paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar shpk me datën 31 Dhjetor 2012, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit

ILD-99 Audit shpk

  
Luan Kamberi  
Ekspert Kontabël i Rregjistruar



Tirane, me 20 Mars 2013

SHQIP – sh.p.k

Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Me 31 Dhjetor 2012

A K T I V E T	Shenime	31.12.2012	31.12.2011
Mjetet Monetare	4	3,928,502	1,011,133
Derivate dhe Aktive Financiare te mbajtur per tregtim		-	-
Derivatet		-	-
Aktivete e mbajtur per tregtim		-	-
<b>Totali</b>		<b>3,928,502</b>	<b>1,011,133</b>
<b>Aktive te tjera Financiare afatshkurter</b>			
Llogari kerkesa te arketueshme	5	16,591,328	17,766,852
Llogari kerkesa te tjera te arketueshme	6	683,321	-
Instrumente te tjera borxhi		-	-
Investime te tjera financiare		-	-
<b>Totali</b>		<b>17,274,649</b>	<b>17,766,852</b>
<b>Inventari</b>			
Lendet e para		-	-
Prodhimi ne proces		-	-
Produkte te gatshme		-	-
Mallra per rishitje	7	744,021	1,037,078
Inventar I Imet		-	-
Parapagesat per furnizime		-	-
<b>Totali</b>		<b>744,021</b>	<b>1,037,078</b>
Aktive Biologjike afatshkurter		-	-
Aktive Afatshkurtra te mbajtur per shitje		-	-
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	8	654,321	733,604
<b>Total i Aktiveve Afatshkurtra</b>		<b>22,601,493</b>	<b>20,548,667</b>
<b>Aktive Afatgjata</b>			
Investime financiare afatgjata		-	-
<b>Totali</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Aktive Afatgjata Materiale</b>			
Toka		-	-
Ndertesa ne Proces		-	-
Makineri dhe pajisje (neto)		154,504	193,132
Aktive te tjera afatgjata materiale (neto)		7,815,363	9,807,628
<b>Totali</b>	9	<b>7,969,867</b>	<b>10,000,760</b>
<b>Aktive Biologjike Afatgjate</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Aktive Afatgjata Jomateriale</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
Kapitali aksionar i papaguar		-	-
Aktive te tjera afatgjata (ne proces)		-	-
<b>Totali i Aktiveve Afatgjata</b>		<b>7,969,867</b>	<b>10,000,760</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>30,571,360</b>	<b>30,549,427</b>

Shenimet e Pasqyrave Financiare nga faqja 7-17 jane pjese e pandashme e tyre

Fortlandua Kosqip  
Shqipëria  
Besnik Myftari  
TIRANE

SHQIP – sh.p.k

Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar  
Me 31 Dhjetor 2012**

<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>	<b>Shenime</b>	<b>31.12.2012</b>	<b>31.12.2011</b>
<b>Detyrimet Afatshkurta</b>			
<b>Derivatet</b>		-	-
<b>Huamarrjet</b>		-	-
Huate dhe obligacionet afatshkurta	10	375,959	-
Kthimet/Ripagimet e huave afatgjata		-	-
Bono te konvertueshme		-	-
<b>Totali</b>		<b>375,959</b>	-
<b>Huate dhe parapagimet</b>			
Te pagueshme ndaj furnitoreve	11	37,336,640	39,411,523
Te pagueshme ndaj punonjesve		-	-
Detyrimet tatimore	12	601,632	656,164
Detyrime te tjera		30,689	-
Parapagimet e arketueshme		-	-
<b>Totali</b>		<b>37,968,961</b>	<b>40,067,687</b>
<b>Grantet dhe te ardhura te shtyra</b>	13	23,259	18,885
<b>Provizionet afatshkurta</b>		-	-
<b>Totali Detyrime Afatshkurtra</b>		<b>38,368,179</b>	<b>40,086,572</b>
<b>Detyrimet Afatgjata</b>			
<b>Huate afatgjata</b>			
Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare		-	-
Bonot e konvertueshme		-	-
<b>Totali</b>		-	-
<b>Huamarrje te tjera afatgjata</b>	14	16,948,341	15,981,010
<b>Provizionet afatgjata</b>		-	-
<b>Grandet dhe te ardhura te shtyra</b>		-	-
<b>Totali Detyrime Afatgjata</b>		<b>16,948,341</b>	<b>15,981,010</b>
<b>Totali i Detyrimeve</b>		<b>55,316,520</b>	<b>56,067,582</b>
<b>Kapitali</b>			
Akisonet e pakices		-	-
Kapitali i aksionereve te shoqerise meme		-	-
Kapitali i aksionar		100,000	100,000
Primi i aksionit		-	-
Njesite ose aksionet e thesarit		-	-
Rezerva statutore		-	-
Rezerva ligjore		-	-
Rezerva te tjera		-	-
Fitimi i pashpermdare		(25,618,157)	(27,163,434)
Fitimi (humbje) e vitit financiar	23	772,997	1,545,279
<b>Totali i Kapitalit</b>		<b>(24,745,160)</b>	<b>(25,518,155)</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>30,571,360</b>	<b>30,549,427</b>

Shenimet e Pasqyrave Financiare nga faqja 7-17 jane pjesë e pandashme e tyre

Fatbardha Kosaj



Besnik Myftari

SHQIP – sh.p.k


Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

**Pasqyra e te Ardhurave e Shpenzimeve  
Me 31 Dhjetor 2012**

Te ardhura e shpenzime	Shenime	31.12.2012	31.12.2011
<b>Te Ardhurat</b>	<b>15</b>	<b>72,477,684</b>	<b>95,564,540</b>
Shitjet neto		19,968,307	27,900,975
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit		52,509,377	67,663,565
Ndryshimet në inventarin e produktevetë gatshme dhe prodhim		-	-
Materialet e konsumuara	<b>16</b>	(26,576,555)	(30,899,811)
<b>Kosto e punës</b>	<b>17</b>	<b>(17,151,904)</b>	<b>(16,962,805)</b>
-pagat e personelit		(14,826,421)	(14,686,853)
-shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore		(2,325,483)	(2,275,952)
-shpenzime per honorare		-	-
Amortizimet dhe zhvlerësimet	<b>18</b>	(2,057,353)	(1,922,862)
Shpenzime të tjera	<b>19</b>	(25,403,683)	(43,193,031)
<b>Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)</b>		<b>(71,189,495)</b>	<b>(92,978,509)</b>
<b>Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore(1+2+/-3-8)</b>		<b>1,288,189</b>	<b>2,586,031</b>
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluar		-	-
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		-	-
<b>Të ardhurat dhe shpenzimet financiare</b>			
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera fin.		-	-
Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	<b>20</b>	(91,175)	(554)
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	<b>21</b>	(72,991)	(3,618)
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	<b>22</b>	82,557	321
<b>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare(12.1+/-12)</b>		<b>(81,609)</b>	<b>(3,851)</b>
<b>Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)</b>		<b>1,206,580</b>	<b>2,582,180</b>
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin		(433,583)	(1,036,901)
Tatim Fitimi i Shtyre		-	-
<b>Fitimi (humbja) neto e vitit financiar(14-15)</b>	<b>23</b>	<b>772,997</b>	<b>1,545,279</b>

Shenimet e Pasqyrave Financiare nga faqja 7-17 jane pjese e pandashme e tyre



SHQIP – sh.p.k

Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

**Pasqyra e Fluksit Monetar  
Me 31 Dhjetor 2012**

<b>Pasqyra e fluksit monetar-Metoda indirekte</b>	<b>Viti 2012 ne Lek</b>	<b>Viti 2011 ne Lek</b>
<b>I Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit</b>		
Fitimi para tatimit	1,206,580	2,582,180
Rregullime per:		
Amortizimin	2,057,353	1,922,862
Humbje nga kembimet valutore	72,991	3,618
Te ardhura nga investimet	-	-
Shpenzime per interesa	-	-
(Rritje) / renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesa te arketueshme te tjera	492,203	1,637,608
(Rritje) / renie ne tepricen e inventarit	293,057	193,648
Rritje / (renie) ne tepricen e detyrimeve, per tu paguar nga aktiviteti	(1,791,388)	10,913,469
(Rritje) / renie ne shpenzime te shtyra	79,283	773,915
Interesi i paguar	-	-
Tatim mbi fitimin i paguar	(433,583)	(1,036,901)
<b>MM neto nga aktivitetet e shfrytezimit</b>	<b>1,976,496</b>	<b>16,990,399</b>
<b>II Fluksi monetar nga veprimtarite investuese</b>		
Blerja e shoqerise se kontrolluar X minus parate e arketuara	-	-
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(26,460)	(3,486,238)
Te ardhura nga shitja e paisjeve		
Interesi i arketuar		
Dividentet e arketuar		
<b>MM neto e perdorur ne aktivitetet investuese</b>	<b>(26,458)</b>	<b>(3,486,236)</b>
<b>III Fluksi monetar nga veprimtarite financiare</b>		
Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner	-	-
Te ardhura nga huamarrje afatgjata	967,331	(15,255,440)
Pagesat e detyrimeve te qirase financiare	-	-
Dividentet e paguar		
<b>MM neto e perdorur ne aktivitetet financiare</b>	<b>967,331</b>	<b>(15,255,440)</b>
<b>Rritja / renia neto e mjeteve monetare</b>	<b>2,917,369</b>	<b>(1,751,277)</b>
<b>Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel</b>	<b>1,011,133</b>	<b>2,762,410</b>
<b>Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel</b>	<b>3,928,502</b>	<b>1,011,133</b>

Shenimet e Pasqyrave Financiare nga faqja 7-17 jane pjese e pangrumbshme e tyre



Gazeta Shqip – sh.p.k  
 Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012  
 (Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

**Pasqyra e Levizjeve te Kapitalit  
 me 31 dhjetor 2012**

	Kapitali Aksionar	Fitimi pashperndare	Fitimi i vitit ushtrimor	Totali i Kapitalit
<b>Pozicioni më 31.12.2010</b>	100,000	(30,742,170)	3,578,734	(27,063,436)
Transferim ne humbje e mbartur		3,578,734	(3,578,734)	-
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	1,545,279	1,545,279
Dividendët e paguar	-	-	-	-
<b>Pozicioni më 31.12.2011</b>	100,000	(27,163,436)	1,545,279	(25,518,157)
Transferim ne humbje e mbartur		1,545,279	(1,545,279)	-
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	772,997	772,997
Dividendët e paguar	-	-	-	-
<b>Pozicioni më 31.12.2012</b>	100,000	(25,618,156)	772,997	(24,745,160)

*Shenimet e Pasqyrave Financiare nga faqja 7-17 jane pjese e pandashme e tyre*

Pasqyrat Financiare te shoqerise per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012 u miratuan nga Administratori i Shoqerise  
 Z. Besnik Myftari

*Besnik Myftari*





SHQIP – sh.p.k

Shenimet per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

*(Te gjitha shumat jane ne Lek, perveç kur shprehet ndryshe)*

## **SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE**

### **1. TE PERGJITHSHME**

Shoqeria Gazeta Shqip sh.p.k eshte krijuar me vendim Gjykate te rrethit Tirane nr. 35118 date 02.03.2006.

Aktiviteti kryesor i saj eshte :

Botimi, prodhimi, dhe shperndarja e gazetave, revistave, librave dhe materialeve te tjera te lejuara me ligj.

Kapitali themeltar eshte: 100.000 leke.

Ortake i vetem i shoqerise eshte shoqeria " Digit – Alb" Sh.a.

Shoqeria "Gazeta Shqip" sh.p.k eshte e regjistruar prane deges se Tatim Taksave Tirane dhe ka paguar rregullisht te gjitha detyrimet tatimore.

### **2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE**

#### **2.1 Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

#### **2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### **2.2 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

#### **2.3 Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyre të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

### **3. POLITIKAT KONTABËL**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat të paraqitura në pasqyrat financiare.



SHQIP – sh.p.k

Shenimet per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

### 3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

	31.12.2012	31.12.2011
<b>Kurse e kembimit</b>		
Euro/Leke	139.59	138.93
USD/ Leke	105.85	107.54

### 3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### Paraja dhe ekuivalentët e parasë (Mjete monetare)

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

#### Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Veshtirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.



SHQIP – sh.p.k

Shenimet per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

*(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)*

### 3. POLITIKAT KONTABËL

#### 3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

*Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshire koston e transaksioneve.

*Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta te përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

*Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

*Kapitali themeltar*

Kapitali njihet me vlerën nominale.

#### 3.3 Aktive afatgjata materiale

##### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

##### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### *iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjate material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.



SHQIP – sh.p.k

Shenimet per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

iii. Amortizimi (vazhdim)

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Makineri dhe pajisje	20%
Mobilje dhe orendi	20%
Pajisje zyrash dhe informatike	25%
Mjete Transporti	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

### 3.4 Zhvlerësimi

#### i. Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3.5 Provizionet


Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, kur Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

### 3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

### 3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi llogaritë dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura si vlerë të drejte nëpërmjet llogarisë fitim/humbje, dhe



SHQIP – sh.p.k

Shenimet per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### 3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

### 4. MJETE MONETARE

Shoqëria ka llogari bankare ne leke dhe ne valute. Per gjendjet ne valute eshte bere rivleresimi me kursin fiks te Bankes se Shqiperise ne dt. 31.12.2012 dhe diferencat jane pasqyruar ne rezultatin e shoqerise. Gjendja e likuiditeteve ne banke dhe ne arke me 31.12.2012 paraqitet si me poshte:

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<b>ne LEK</b>	<b>ne LEK</b>
Vlera monetare ne LEK	<b>3,599,009</b>	<b>807,600</b>
Banka	3,280,711	623,386
Arka	318,298	184,214
Vlera monetare ne Valute	<b>329,493</b>	<b>203,533</b>
Banka	329,117	98,472
Arka	376	105,061
<b>Total</b>	<b>3,928,502</b>	<b>1,011,133</b>

### 5. LLOGARI TE ARKETUESHME

Llogari te arketueshme perfaqeson gjendjen e klienteve te palikujduar ne fund te periudhes si me poshte:

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<b>ne LEK</b>	<b>ne LEK</b>
Kliente	16,591,328	17,766,852
<b>Total</b>	<b>16,591,328</b>	<b>17,766,852</b>

### 6. KERKESA TE TJERA TE ARKETUESHME

Ne kete ze paraqitet tatim fitimi i parapaguar si me poshte:

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<b>ne LEK</b>	<b>ne LEK</b>
Tatim fitimi	683,321	-
<b>Total</b>	<b>683,321</b>	-



SHQIP – sh.p.k

Shenimet per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, perveç kur shprehet ndryshe)

**7. INVENTARI**

Inventari i shoqerise perbehet nga sasia gjendje e gazetes ne fund te periudhes e vleresuar me kosto ne vleren si meposhtme:

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<i>ne LEK</i>	<i>ne LEK</i>
Mallra per shitje	744,021	1,037,078
<b>Total</b>	<b>744,021</b>	<b>1,037,078</b>

**8. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TE SHTYRA**

Ky ze perfaqeson shpenzime te shtyra te cilat u perkasin periudhave te ardheshme dhe lidhen me shpenzime per prime sigurimi.

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<i>ne LEK</i>	<i>ne LEK</i>
Shpenzime te shtyra	654,321	733,604
<b>Total</b>	<b>654,321</b>	<b>733,604</b>

**9. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

	<b>MOBILJEE ORENDI</b>	<b>MJETE TRANSPORTI</b>	<b>PAJISJE KOMJUTERIKE</b>	<b>PAJISJE ZYRE INSTALIME TEKNIKE</b>	<b>TE TJERA</b>	<b>TOTAL</b>
<b>Me Kosto</b>						
<b>Ne 1 Janar 2012</b>	3,553,401	9,793,950	8,010,101	642,233	2,556,668	<b>24,556,353</b>
Shtesa	88,800	435,684	57,500	-	214,120	<b>796,104</b>
Pakesime	-	2,951,400				<b>2,951,400</b>
<b>Ne 31 Dhjetor 2012</b>	<b>3,642,201</b>	<b>7,278,234</b>	<b>8,067,601</b>	<b>642,233</b>	<b>2,770,788</b>	<b>22,401,057</b>
<b>Amortizimi i Akumuluar</b>						
<b>Ne 1 Janar 2012</b>	2,128,095	4,092,093	6,150,490	449,106	1,735,810	<b>14,555,594</b>
Amortizimi i vitit	285,061	1,096,908	466,892	38,625	169,865	<b>2,057,352</b>
Kthim amortizimi	-	(2,181,755)				<b>(2,181,755)</b>
<b>Ne 31 Dhjetor 2012</b>	<b>2,413,156</b>	<b>3,007,246</b>	<b>6,617,382</b>	<b>487,732</b>	<b>1,905,675</b>	<b>14,431,190</b>
<b>Neto me 1 Janar 2012</b>	<b>1,425,307</b>	<b>5,701,857</b>	<b>1,859,611</b>	<b>193,126</b>	<b>820,859</b>	<b>10,000,760</b>
<b>Neto me 31 Dhjetor 2012</b>	<b>1,229,045</b>	<b>4,270,988</b>	<b>1,450,219</b>	<b>154,501</b>	<b>865,113</b>	<b>7,969,867</b>



*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

SHQIP – sh.p.k

Shenimet per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

**10. HUAMARRJE AFATSHKURTER**

Ne kete ze paraqitet huamarrje afatshkurter e marre nga banka si me poshte:

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<b>ne LEK</b>	<b>ne LEK</b>
Huamarrje Afatshkurter	375,959	-
<b>Total</b>	<b>375,959</b>	<b>-</b>

**11. LLOGARI TE PAGUESHME**

Ky ze perfaqeson shumat qe shoqeria u detyrohet furnitoreve per furnizime me mallra e sherbime ne mbyllje te vitit ushtrimor. Gjithashtu brenda grupit te furnitoreve jane perfshire dhe furniture per fatura te pamberritura sipas tabelës me poshte:

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<b>ne LEK</b>	<b>ne LEK</b>
Furnitore	37,168,882	38,990,121
Furnitor per fatura te pamberritura	167,758	421,402
<b>Total</b>	<b>37,336,640</b>	<b>39,411,523</b>

**12. DETYRIME TATIMORE**

Detyrimet tatimore perfaqesojne detyrime ndaj organeve tatimore per TVSH e muajit Dhjetor 2012, per tatimin ne burim, tatimin mbi pagat e muajit Dhjetor 2012 si dhe detyrimin ndaj sigurimeve shoqerore e shendetesore per pagat e muajit Dhjetor 2012 si me poshte:

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<b>ne LEK</b>	<b>ne LEK</b>
Tatim ne burim	40,000	37,900
Tatim mbi Fitim	-	144,869
TVSH per t'u paguar	75,012	10,196
Sigurime shoqerore e shendetesore	354,420	337,699
Tatim Page	132,200	125,500
<b>Total</b>	<b>601,632</b>	<b>656,164</b>



SHQIP – sh.p.k

Shenimet per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

### 13. TE ARDHURAT E SHTYRA

Ne kete ze jane perfshire te ardhurat e shtyra te cilat lidhen me abonimet e bera ne vitin 2012 dhe qe i perkasin periudhes ne vazhdim:

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<b>ne LEK</b>	<b>ne LEK</b>
Te ardhura te shtyra - abonime	23,259	18,885
<b>Total</b>	<b>23,259</b>	<b>18,885</b>

### 14. HUAMARRJE AFATGJATA

Ne kete ze paraqitet huaja afagjate si me poshte:

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<b>ne LEK</b>	<b>ne LEK</b>
Huamarrje Afatgjata	16,948,341	15,981,010
<b>Total</b>	<b>16,948,341</b>	<b>15,981,010</b>

### 15. TE ARDHURAT

Te ardhurat jane realizuar nga veprimtaria kryesore e shoqerise.

Te ardhurat e deklaruar sipas FDP-ve gjate vitit 2012 rezultojne ne shumen 73,251,703 Leke krahasuar me ato te kontabilitetit ne shumen 72,477,684 leke.

Diferenca prej 774,019 Leke (me shume ne kontabilitet) vjen si rezultat i a) (769,645) te ardhura nga shitja e AAM-ve e paraqitur ne pasqyra me vlere neto b) shuma e abonimeve te cilat jane shtyre nga te ardhurat e kontabilitetit per ne vitin 2013 me vlere (23,259) Leke si dhe nga shuma e te ardhurave te shtyra te vitit 2011 me vlere 18,885 leke te cilat jane perfshire ne te ardhurat e vitit 2012 ne kontabilitet.

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<b>ne LEK</b>	<b>ne LEK</b>
Te ardhura nga shitja	19,968,307	27,900,975
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	52,509,377	67,663,565
<b>Total</b>	<b>72,477,684</b>	<b>95,564,540</b>

### 16. MATERIALE TE KONSUMUARA

Ky ze perbehet nga materialet e konsumuara si me poshte:

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<b>ne LEK</b>	<b>ne LEK</b>
Blerje letre per shtyp	-	781,423
Kosto e mallit te shitur	19,300,277	22,006,765
Sherbim fotografik & design	7,276,278	8,111,623
<b>Total</b>	<b>26,576,555</b>	<b>30,899,811</b>





SHQIP – sh.p.k

Shenimet per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

#### 17. SHPENZIMET E PERSONELIT

Ky ze perbehet nga shpenzimet per pagat e personelit dhe kontributet per sigurime shoqerore e shendetesore si me poshte:

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<b>ne LEK</b>	<b>ne LEK</b>
Pagat e personelit	14,826,421	14,686,853
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	2,325,483	2,275,952
<b>Total</b>	<b>17,151,904</b>	<b>16,962,805</b>

#### 18. AMORTIZIMI DHE ZHVLERESIMET

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<b>ne LEK</b>	<b>ne LEK</b>
Shpenzimi Amortizimi	2,057,353	1,922,862
<b>Total</b>	<b>2,057,353</b>	<b>1,922,862</b>

#### 19. SHPENZIME TE TJERA

Shpenzimet e tjera administrative jane analizuar ne tabelen e meposhtme:

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<b>ne LEK</b>	<b>ne LEK</b>
Karburant	1,900,491	2,093,900
Shpenzime abonimi	530,195	656,740
Qera	2,001,996	2,020,344
Mirembajtje & Riparime e punime	229,248	1,448,565
Prime te sigurimit	996,853	692,465
Komisione dhe honorare	4,211,000	4,130,000
Shpenzime publiciteti & reklame	6,647,710	17,189,817
Shpenzime tek komunikacioni dhe postare	3,261,810	4,365,086
Komisione & Transport	784,762	930,628
Taksa dhe tarifa vendore	35,915	85,920
Te tjera	4,803,703	9,579,566
<b>Total</b>	<b>25,403,683</b>	<b>43,193,031</b>



SHQIP – sh.p.k

Shenimet per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

**20. TE ARDHURA E SHPENZIME NGA INTERESAT**

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<b>ne LEK</b>	<b>ne LEK</b>
Shpenzime për interesa	(92,307)	(1,579)
Të ardhura nga interesat	1,132	1,025
<b>Total</b>	<b>(91,175)</b>	<b>(554)</b>

**21. FITIM HUMBJE NGA KURSI I KEMBIMIT**

Diferencat nga ndryshimi i kursit te kembimit jane paraqitur neto ne Pasqyren e Rezultatit dhe perbehen nga fitime/(humbje) perkatesisht sipas tabelës se meposhtme:

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<b>ne LEK</b>	<b>ne LEK</b>
Humbje nga kursi i kembimit	(232,176)	(325,666)
Fitime nga kursi i kembimit	159,185	322,048
<b>Total</b>	<b>(72,991)</b>	<b>(3,618)</b>

**22. TE ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE TE TJERA**

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<b>ne LEK</b>	<b>ne LEK</b>
Shpenzime financiare e te tjera	-	(344)
Te ardhura financiare e te tjera	82,557	665
<b>Total</b>	<b>82,557</b>	<b>321</b>

**23. TATIM FITIMI DHE REZULTATI TATIMOR**

	<b>2012</b>	<b>2011</b>
	<b>ne LEK</b>	<b>ne LEK</b>
<b>Rezultati tatimor</b>	<b>Vlera ne leke</b>	<b>Vlera ne leke</b>
Fitimi/(Humbja) para tatimit	1,206,580	2,582,180
Shpenzime te panjohura	3,129,254	7,786,833
Fitimi fiskal	4,335,834	10,369,013
Tatim fitimi (10 %)	433,583	1,036,901
<b>Fitimi/(Humbja) Neto</b>	<b>772,997</b>	<b>1,545,279</b>



SHQIP – sh.p.k

Shenimet per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

(Te gjitha shumat jane ne Lek, pervec kur shprehet ndryshe)

**TATIM FITIMI**

	<b>2012</b>
	<b>ne LEK</b>
Tatim Fitim i mbartur	-
Tatim Fitimi i derdhur gjate periudhes	<u><b>1,116,904</b></u>
<b>Tatim Fitim i parapaguar</b>	<b>1,116,904</b>
Tatim Fitimi viti ushtrimor 2012	433,583
Tatim Fitim derdhur me teper	<u>683,321</u>
Tatim Fitim per t'u paguar	<u>-</u>

**24. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT**

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.

